

MENAXHIMI DHE RUAJTJA E DOKUMENTACIONIT ARKIVOR NË ARKIVIN  
KOMUNAL TË VUSHTRISË

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I HISTORISË-PROGRAMI ARKIVISTIKË

NGA

DONJETË SINANI



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**

**FAKULTETI FILOZOFIK**

**DEPARTAMENTI I HISTORISË-PROGRAMI ARKIVISTIKË**

PRISHTINË

Maj, 2023

## **REZYME**

### **MENAXHIMI DHE RUAJTJA E DOKUMENTACIONIT ARKIVOR NË ARKIVIN KOMUNAL TË VUSHTRISË**

Nga: DONJETË SINANI

MENTOR: Prof.Dr.Ibrahim Gashi

Realizimi mbi trajtimin e temës me titull: “Menaxhimi dhe ruajtja e dokumentacionit arkivor në Arkivin Komunal të Vushtrrisë” në kuadër të karakterit profesional-shkencor nuk është trajtuar nga askush deri më tani, ku si punim ngërthen në vete çështje parësore dhe shfaq mënyrën e menaxhimit mbi ruajtjen dhe rëndësinë e lëndëve arkivore të ruajtura në këtë arkiv.

Koncepti arkivistikë nënkupton se arkivistika është diciplinë shkencore e cila merret me studimin teorik dhe praktik si dhe me aplikim të metodave dhe parimeve të punës të krijimit, mbrojtjes, ruajtjes, rregullimit, përpunimit, vlerësimit, shfrytëzimit e deri te publikimi i lëndës arkivore.

Qëllimi parësor i këtij punimi është që të shfaqë mënyrën e menaxhimit mbi ruajtjen dhe rëndësinë e lëndëve arkivore të ruajtura në këtë arkiv, ku natyra e dokumenteve arkivore është e llojeve të ndryshme duke u nisur nga karakteri pronsoro-juridik, arsimor dhe dosje personale të punëtorëve të Komunës së Vushtrrisë.

Konkretisht shumica e dokumenteve që ruhen janë nga Organet e Jurisprudencës të fondit së Gjykatës Komunale të viteve (1945-1991), ku edhe i shton rëndësinë e madhe mbi ruajtjen e këtyre dokumenteve.

I gjithë punimi përbëhet nga tre kapituj, në kapitullin e parë përfshihet rëndësia e arkivave në përgjithësi si dhe paraqiten të dhëna mbi Arkivin Komunal të Vushtrrisë prej krijimit të tij i cili më parë ka qenë nën kompetencat e Arkivit Ndërkomunal të Mitrovicës dhe më pas është ndarë si arkiv i pavarur, si dhe procesin e pranim dorëzimit mbi lëndët arkivore.

Kapitulli i dytë përfshin vlerësimin e lëndëve arkivore dhe listën e afateve të ruajtjes si dhe fazat e rregullimit të lëndës arkivore, menaxhimin me dokumente ku njëherësh është edhe tema bosht e kësaj teze si dhe sa janë të aplikueshme standardet ndërkombëtare në këtë arkiv.

Ndërsa, kapitulli i fundit vë në pah pikat mbi mbrojtjen juridike dhe shërbimin e lëndës arkivore, ndryshimet e legjislacionit në Kosovë, ku konkretisht në vendin tonë për shkak të sundimit shekullor nga të huajt, mungonte kujdesi për dokumentet e shkruara, ndërsa okupatorët dokumentet me rëndësi të posaçme historike e shkencore i shkatërronin ose i bartnin në arkivat e veta.

Më pas shtjellohen pikat mbi qasjen dhe shfrytëzimin e deri te publikimi në lëndën arkivore, ku si parim theksohet se arkivat ofrojnë mundësi që brezat e ardhshëm të njihen me të kaluarën tonë duke u mundësuar qasjen dhe shfrytëzimin deri në publikimin e dokumenteve të caktuara duke ruajtur konfidencialitetin në përputhshmëri me ligjin mbi arkivat. Arkivi Komunal i Vushtrisë i takon rrjetit arkivor të Kosovës, nën Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës. Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës dhe financimit e kryen Komuna e Vushtrisë dhe funksionon në kuadër të Drejtorisë Pronësore-Juridike.

Krejt në fund shtjellimi i temës bazohet në nevojën për hulumtim të kësaj teze ku është bërë edhe përzgjedhja e metodës e cila është praktikuar gjatë realizimit të punimit, me metodat hulumtuese nga ajo sasiore dhe cilësore. Si dhe tregohen konkludimet duke u bazuar në arritjet hulumtuese dhe aftësitë profesionale gjatë studimit të kësaj teme si dhe janë dhënë rekomandime.